



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 4.3.2025

Nr: 233

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUDHËN 23 SHKURT-1 MARS 2025

Sot, më datë 4.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

OBJEKT: Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 23 shkurt deri më 1 mars 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 23 shkurt deri më 1 mars 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Bashkisë Bulqizë.
3. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Bashkisë Kuçovë.

Data: 4.3.2025 Nr: 233
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 23 shkurt – 1 mars 2025”

4. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Bashkisë Tiranë.
5. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Finiq.
6. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Zyrës Vendore Arsimore Shkodër
7. Fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.
8. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI